

VENDIM
Nr. 676, datë 16.8.2013

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR PRESIDENCËN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Presidencës, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, t’i shtohet fondi prej 5 000 000 (pesë milionë) lekësh, për shpenzime korente.
 2. Ky efekt të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit, miratuar për vitin 2013.
 3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha